



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
KOMISIONERI**

Nr. 1141/1 Prot.

Tiranë, më 06.08. 2026

V E N D I M

Nr. 212, Datë 06.08.2026

Bazuar në nenet 32 dhe 33 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”¹, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi², mori në shqyrtim ankesën nr.150 Regj., datë 17.06.2026, të paraqitur nga znj. I.L kundër z.E.M , Kryetar i Këshillit të Qarkut Vlorë dhe znj. A.H , Drejtore e Drejtorisë së Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Social, Këshilli i Qarkut Vlorë, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “*gjendjes familjare*” dhe në kuadër të “*çdo shkak tjetër*”³.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues

Në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit, ankuesja I.L , informon se, është nëpunëse civile pranë Këshillit të Qarkut Vlorë që prej vitit 2022, me detyrë Specialiste për Arsimin, Kulturën, Turizmin, Çështjet Sociale dhe Zhvillimin e Projekteve. Ajo parashtroi se, në bazë të aktit të emërimit dhe të urdhrave të brendshëm është ngarkuar me menaxhimin e tre projekteve me financim të huaj,

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

³ Shkaku i diskriminimit i pretenduar nga ankuesja në kuadër të “*çdo shkak tjetër*” është: “*Cilësia si punonjëse që kundërshtoi zbatimin e një urdhri të paligjshëm dhe që raportoi paligjshmërinë e konstatuar tek eprorët dhe tek organet kompetente (refuzimi i protokollimit të kontratës me nënshkrime elektronike të datave 24.02/26.02.2026 dhe raportimi i ndërhyrjes në regjistrin e protokollit)*”

detyrë që, sipas saj, e ka ushtruar prej disa vitesh pa asnjë problematikë dhe duke zbatuar me përpikëri legjislacionin në fuqi.

Ankuesja parashtron se një tregues i hershëm i mënyrës personale të drejtimit të institucionit shfaqet më 19.02.2026, kur, në një mbledhje me stafin, z. M , Kryetar i Këshillit të Qarkut Vlorë i është drejtuar me fjalët “ky institucion është imi, e kam krijuar unë, do t’ju mbys, po nuk u bindët do ikni që këtu, pyesni ata që kanë ikur para jush”. Ajo pretendon se konflikti konkret ka filluar më datë 10.03.2026, kur është thirrur nga eprorja e saj direkte znj. A.H , Drejtore e Drejtorisë së Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Social, në zyrën e Kryetarit dhe, pas presionit të ushtruar lidhur me operatorin ekonomik fitues të një procedure prokurimi, ai i është drejtuar me fjalët “*merre këtë dhe nxirre jashtë*”. Tri ditë më pas, më 13.03.2026, ankuesja pretendon se, ka kundërshtuar protokollimin e një kontrate me data dhe procedura që i konsideron të parregullta, dhe pikërisht po atë ditë ndaj saj është marrë masa disiplinore “Vërejtje” me njoftimin Nr. 698 Prot, për të cilën pretendon se ka marrë dijeni vetëm më datë 08.04.2026.

Ankuesja parashtron se, znj. H. ka ndërhyrë në zyrën dhe dokumentacionin e saj gjatë mungesës (17.03–07.04.2026), pa e njoftuar në asnjë formë dhe mbledhjen vijuese i është drejtuar ankueses me fjalë denigruese “nuk je e pazëvendësueshme dhe s’do të presim ne ty kur të vish ti”, në prani të kolegëve, situatë që ankuesja e cilëson si “të paprecedentë” që cenon rëndë dinjitetin e saj profesional.

Ankuesja informon se, gjatë periudhës 15.03–02.04.2026, babai i saj është shtruar në spital dhe ajo ka marrë leje të zakonshme për ta shoqëruar. Më 08.04.2026, po ditën kur i është njoftuar masa “Vërejtje” dhe në mbyllje të orarit zyrtar (ora 15:47), është nxjerrë shkresa nr. 863, që kërkon dorëzimin nga ana e saj të dosjeve voluminoze brenda një afati të shkurtër. Të nesërmen, më 09.04.2026, është nxjerrë Urdhri Nr. 61 për ndryshimin e adresës elektronike, i cili sipas saj u përdor për t’i hequr aksesin në sistemin e njërës prej projekteve. Ankuesja shpjegon se pasojat e këtij veprimi u shfaqën shpejt, pasi më datë 20.04.2026 Lead Partner-i i projektit e informoi se ishte “disinformuar qëllimisht” se ajo “nuk punonte më” në Këshillin e Qarkut, informacion që erdhi përmes një ftese në kopje adresë të znj. H. .

Situata, sipas ankueses, vijoi të rëndohej. Kështu më datë 04.05.2026, znj. H. hyri në zyrën e saj, e fyeu bashkë me bashkëshortin, dhe e kërcënoi, duke përdorur fjalë denigruese ndaj saj dhe bashkëshortit si “ai burri jot lepur burracak, merret me gratë, s’ka lindur ai që më bën mua kështu” dhe e kërcënoi haptazi në prani të kolegëve. Në lidhje me këtë situatë ankuesja pretendon se iu drejtua Policisë me kallëzim.

Ankuesja thekson se, pikërisht në një moment vulnerabiliteti, duke ju referuar sëmundjes së rëndë të babait të saj (tumor, ndërhyrje kirurgjikale dhe kimioterapi gjatë periudhës 15.03–02.04.2026), eprorët e saj kanë intensifikuar presionin. Ajo e cilëson këtë shfrytëzim të gjendjes së saj familjare si trajtim të disfavorshëm lidhur drejtpërdrejt me gjendjen familjare, sipas nenit 1 të Ligjit nr.

10221/2010, dhe thekson se sjellja e znj. H. “nuk është një episod i izoluar, por një metodë e përsëritur” për të krijuar situata të pavërteta si pretekst ndëshkimi.

Ankuesja informon se, më 06.05.2026 u mbajt një mbledhje për “Planin Social Rajonal”, fushë që sipas saj përbën kompetencën e saj të drejtpërdrejtë, për të cilën mori dijeni vetëm nëpërmjet mediave. Gjatë datave 13.05.2026 dhe 18.05.2026, ankuesja shpjegon se, iu drejtuan Urdhrat nr. 83, nr. 85 dhe nr. 86, për pjesëmarrje në aktivitete jashtë orarit dhe jashtë qytetit, me afate që sipas saj janë objektivisht të përealizueshme.

Ankuesja parashtron se, më datë 21.05.2026 ka paraqitur kallëzim penal pranë Seksionit të Krimit Ekonomik, për ndërhyrjen e dyshuar në regjistrin e protokollit dhe për shpërdorim detyre.

Gjatë periudhës 22–25.05.2026, ankuesja parashtron se, i kanë ardhur si “urgjente” alarme nga Sekretariati i Përbashkët Grek i Projektit, me afat 25.05.2026 dhe me kërcënim për masë disiplinore, ndaj të cilave ajo është përgjigjur se nuk kishte akses dhe dokumente për t'i përmbushur.

Ankuesja parashtron se, në muajin janar 2026, pas kërkesës së saj ishte lejuar të merrte pjesë në një trajnim në lidhje me detyrat e saj si menaxhere projekti, me institutin ISSAT, sipas kontratës nr.228, datë 23.01.2026, trajnim i parashikuar në buxhetin e institucionit. Ankuesja pretendon se, pas kundërshtimit të saj ndaj urdhrave të paligjshëm, znj. H. nuk ka vijuar me zbatimin e kësaj kontrate, duke mos kryer pagesën e dakortësuar me pretekstin e mospajisjes së ankuses me certifikatën përfundimtare.

Ankuesja pretendon se trajtimi i padrejtë ndaj saj nuk ushtrohet vetëm nga znj. H. , por me lejimin dhe mbështetjen e drejtpërdrejtë të z. M , i cili e ka lejuar znj. H. të veprojë duke tejkaluar kompetencat e saj, dhe ka injoruar qëllimisht çdo komunikim shkresor kundërshtues të ankuses, ndërkohë që çdo konstatim i saj merrte përgjigje nga znj. H. , fakt që, sipas saj, tregon lidhjen e ngushtë bashkëpunuese mes të dyve.

Ankuesja pretendon se, ka mësuar nga kolegët për një kërkesë të z. M për nisjen e një procedimi disiplinor dhe ngritjen e komisionit disiplinor ndaj saj, pa iu paraqitur ende asnjë dokument zyrtar apo vendim, çka e thellon sipas saj karakterin viktimizues dhe joproporcional të trajtimit.

Ankuesja thekson se trajtimi diskriminues dhe viktimizues ndaj saj nuk buron nga institucioni si person juridik, por nga këta dy persona, z. E.M dhe znj. A.H , të cilët, në bashkëpunim me njëritjetrin dhe duke e trajtuar institucionin si “pronë private të tyre”, kanë krijuar e mbajtur ndaj saj një klimë presioni dhe ndëshkimi dhe për këtë arsye ankesa ngrihet ndaj tyre si persona fizikë përgjegjës. Ankuesja pohon se e gjithë kjo situatë e vazhdueshme, përgjatë rreth katër muajve, i ka shkaktuar një rëndesë të madhe emocionale dhe psikologjike, për të cilën merr asistencë psikologjike prej muajit prill 2026.

Përfundimisht, pala ankuese kërkon nga Komisioneri, konstatimin e diskriminimit në të drejtën për punësim sipas nenit 12/1 të ligjit nr. 10221/2010, konstatimin e diskriminimit lidhur me gjendjen familjare, konstatimin e viktimizimit sipas nenit 3/17 të ligjit nr.10221/2010 dhe marrjen e masave e rekomandimeve për ndalimin e praktikës diskriminuese e viktimizuese dhe garantimin e trajtimit të barabartë në vendin e punës.

II. Procedura e ndjekur nga Komisioneri për shqyrtimin e ankesës

1. Në kuadër të shqyrtimit paraprak, Komisioneri konstatoi se, ankesa kishte mangësi të anës formale dhe në këtë kuadër, me *e-mailin* e datës 29.06.2026, kërkoj nga pala ankuese plotësimin dhe saktësimin e ankesës, me informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm në lidhje me, shkaqet e pretenduara të diskriminimit, veprimet dhe mosveprimet konkrete diskriminuese që lidhen me secilin prej këtyre shkaqeve, si dhe pretendimin për viktimizim, sipas nenit 3, pika 17, të LMD-së.
2. Pala ankuese ka kthyer përgjigje me *e-mailin* e datës 09.07.2026. Në kushtet kur një pjesë e dokumentacionit të përcjellë nëpërmjet *e-mailit* të datës 09.07.2026 nuk ishte i aksesueshëm dhe nuk i mundësonte Komisionerit vlerësimin e plotësimit të ankesës, ankuses iu kërkuar nëpërmjet *e-mailit* të datës 16.07.2026, ridërgimi i dokumentacionit.
3. Ankuesja dërgoi nëpërmjet *e-mailit* të datës 17.07.2026 dokumentacionin në format të aksesueshëm dhe njëkohësisht informacionin plotësues në lidhje me sa ishte kërkuar në kërkesën për plotësimin e ankesës. Ndër të tjera, në informacionin plotësues, pala ankuese parashtroi se:

Ankuesja parashtroi se të gjitha pasojat e paraqitura në ankesën nr. 150 e kanë zanafillën në një akt të vetëm. Më 13.03.2026, gjatë ushtrimit të detyrës, ajo refuzoi të protokollonte një kontratë me parregullsi dhe ajo e kundërshtoi këtë veprim si shkelje të Kodit të Procedurave Administrative, të rregullores PRAG të Bashkimit Europian dhe të rregullave të protokollit. Po atë ditë, 13.03.2026, eprorja e saj direkte, znj. A.H , nxori ndaj saj masën disiplinore “Vërejtje”, njoftuar me shkresën Nr. 698 Prot, datë 13.03.2026, për të cilën ajo pretendon se ka marrë dijeni vetëm më 08.04.2026. Ankuesja e vë theksin te fakti se përkimi brenda së njëjtës ditë të refuzimit të saj me masën ndëshkuese është "fakt objektiv".

Ankuesja parashtroi se çdo akt pasues është përshkallëzim i të njëjtit reagim, i dokumentuar shkresërisht nëpërmjet: shkresës nr. 743 Prot (24.03.2026), me afat 26.03.2026, e drejtuar ndërsa ajo ndodhej me raport mjekësor dhe leje për të shoqëruar babain e sëmurë rëndë në spital; shkresës nr. 863 prot datë 08.04.2026 (dërguar në orën 15:47, në përfundim të orarit zyrtar), me afat njëditor për inventarizimin e dosjeve voluminoze, menjëherë me kthimin e saj në punë; Urdhrit nr.

61, datë 09.04.2026, mbi bazën e të cilit iu hoq akses i elektronik i nevojshëm për detyrën; refuzimi i ngritjes së grupit të punës për dorëzimin e dosjeve (shkresa nr. 863/2, datë 15.04.2026); urdhrat nr. 67 dhe nr. 68 datë 27.04.2026, me afate brenda ditës; konfrontimi i datës 04.05.2026 në zyrën e saj, me kërcënime dhe fjalë denigruese ndaj saj dhe familjes, në prani të kolegëve; urdhrat personalë nr. 83, datë 13.05.2026, nr. 85 dhe nr. 86 datë 18.05.2026, drejtuar vetëm ndaj saj; “tërheqja e vëmendjes” me shkresën nr. 1273 datë 15.05.2026, e rikonfirmuar me shkresën nr. 1273/02 datë 19.05.2026, me konotacione të përsëritura ndëshkimore; si dhe mospagesa e detyrimit financiar për trajnimin pranë qendrës ISSAT, e konfirmuar dhe e vijuar edhe pas paraqitjes së ankesës. Ankuesja thekson se ky trajtim bie ndesh me faktin, të pakontestuar nga institucioni, se në vlerësimin e fundit të punës ajo është vlerësuar “shumë mirë”, dhe se asnjë nga kërkesat e saj për sqarime nuk ka marrë përgjigje mbi themel.

Ankuesja parashtro se disponon tregues seriozë se ndaj saj po zhvillohet një procedim disiplinor formal pa asnjë njoftim dhe pa asnjë mundësi dëgjimi. Konkretisht, sipas ankuese, më datë 08.04.2026 ajo u thirr në një mbledhje që u mbajt me protokoll, pa iu paraqitur asnjë dokument dhe pa iu sqaruar objekti i saj. Në shkresat nr. 1273, datë 15.05.2026 dhe nr. 1273/02, datë 19.05.2026, citohen në mënyrë të përsëritur dispozitat për masat disiplinore, në funksion paralajmërues, dhe më datë 20.04.2026, partnerët e huaj të projektit janë kontaktuar me e-mail, të shqetësuar, pasi ishin informuar, jo prej ankuses, se bashkëpunimi i ankuese me institucionin nuk vijonte, pra brenda dhe jashtë institucionit qarkullonte informacion për largimin e saj, ndërkohë që asaj nuk i ishte komunikuar ende asgjë zyrtarisht.

Ankuesja saktëson shkakun e pretenduar në kuadër të çdo shkak tjetër”, sipas nenit 1, të LMD-së si vijon: "cilësia si punonjëse që kundërshtoi zbatimin e një urdhri të paligjshëm dhe që raportoi paligjshmërinë e konstatuar tek eprorët dhe organet kompetente" (refuzimi i protokollimit të kontratës me nënshkrime elektronike të datave 24.02/26.02.2026 dhe raportimi i ndërhyrjes në regjistrin e protokollit)” Ajo argumenton se kjo karakteristikë është e identifikueshme dhe objektive, në kuptim të testit të zhvilluar nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut për "statuse të tjera" sipas nenit 14 të KEDNJ-së, test të cilit i referohet rregullisht edhe vetë Komisioneri në praktikën e tij. Sipas ankuses, statusi i personit që sinjalizon paligjshmërinë njihet shprehimisht nga rendi juridik shqiptar përmes Ligjit nr. 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve", i cili ndalon hakmarrjen ndaj tij, çka e bën këtë status objektivisht të dallueshëm dhe të mbrojtur me ligj. Thekson gjithashtu se vetë Gjykata e Lartë ka pohuar shprehimisht se shkaqet e mbrojtura nga ligji nr. 10221/2010 nuk janë shteruese. Në rastin e saj, ky status nuk mbetet abstract, pasi ajo ka paraqitur pranë ILDKPKI-së kërkesë për njohjen e statusit të sinjalizueses dhe për mbrojtje nga hakmarrja, sipas neneve 18 dhe 19 të Ligjit nr. 60/2016. Ky kualifikim, sipas ankuses, mbështetet drejtpërdrejt edhe në praktikën vendimmarrëse të Komisionerit.

Në lidhje me shkakun “gjendja familjare”, ankuesja parashtro se gjendja e saj familjare, si shkak i mbrojtur shprehimisht nga neni 1 i LMD-së, konsiston në detyrimin e saj ligjor dhe njerëzor si kujdestare e drejtpërdrejtë e babait të sëmurë rëndë me tumor, të nënshtruar ndërhyrjeve

kirurgjikale dhe kimioterapive. Babai i saj ka qenë i shtruar në spital në periudhën 15.03–02.04.2026 dhe, sipas udhëzimit të mjekëve, duhej të shoqërohej prej saj në ndjekjet spitalore dhe ambulatorë;. Për këtë arsye ka munguar në punë me leje të zakonshme, si dhe në raste të tjera gjatë periudhës objekt ankese. Ajo parashtro se sjelljet konkrete që lidhen me këtë shkak nuk qëndrojnë thjesht në mosdhënien e lehtësirave, por në shfrytëzimin e mungesës së saj të ligjshme dhe të gjendjes së saj familjare e psikologjike si mjet presioni, duke renditur: shkresën nr. 743 Prot (24.03.2026), me afat përgjigjeje 26.03.2026, drejtuar pikërisht gjatë periudhës kur ajo ndodhej me raport dhe leje pranë babait të shtruar në spital; shkresën nr. 863 (08.04.2026, ora 15:47), me afat një-ditor për inventarizimin e dosjeve voluminoze, pra në ditën e parë të kthimit të saj nga shoqërimi i babait, në kushte kur përmbushja ishte objektivist e pamundur; refuzimin e kërkesës së saj për ngritjen e një grupi pune për dorëzimin e dosjeve, me shkresën nr. 863/2 (15.04.2026); shkresën e datës 22.05.2026, kur, ndërsa mungonte për arsye shëndetësore, iu dërgua kërkesë për përgjigje urgjente, nën paralajmërimin se moskthimi i përgjigjes do të konsiderohej moskryerje detyre me pasoja disiplinore dhe financiare; dhe episodin e 04.05.2026, kur znj. H. , në prani të personave të tjerë, përdori fjalë denigruese ndaj saj dhe bashkëshortit, duke e kthyer situatën e saj familjare dhe personale në objekt sulmi. Ankuesja mbështet këtë shkak në qëndrimin e vetë Komisionerit, sipas të cilit mungesat e justifikuara me raport mjekësor ose leje të ligjshme nuk mund të përdoren në disfavor të punëmarrësit, dhe barra për të siguruar vazhdimësinë e punës gjatë mungesave të ligjshme i takon punëdhënësit, jo punëmarrësit. Sipas saj, instrumentalizimi i mungesave të saj familjare si rast për ngarkim me afate të pamundura përbën trajtim të disfavorshëm të lidhur shkakësisht me gjendjen familjare.

Në lidhje me pretendimin për viktimizim, sipas nenit 3/17 të LMD-së, ankuesja sqaron se kallëzimet e saj penale dhe ankesa pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil (datë 26.05.2026) kanë pasur si objekt ligjshmërinë e akteve (ndërhyrjen në regjistrin e protokollit, kontratën me nënshkrime të parregullta, përdorimin disproporcional të kompetencës hierarkike), dhe jo pretendimin për trajtim të pabarabartë. Për këtë arsye, sipas saj, ato nuk paraqiten si “ankim a procedim që synon zbatimin e parimit të barazisë” në kuptimin e ngushtë të nenit 3/17, por paraqiten si argumenta në kuadër të shkakut të pretenduar të diskriminimit “çdo shkak tjetër” (raportimi i paligjshmërisë). Ankuesja parashtro se në kuadër të përcaktimeve sipas nenit 3/17, të LMD-së, vetë ankesa e saj nr. 150, datë 17.06.2026, e paraqitur pranë Komisionerit, është pa asnjë dyshim një procedim që synon zbatimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit.

Ankuesja parashtro se një pasojë tjetër negative pas paraqitjes së ankesës tashmë ka ndodhur dhe po vijon. Konkretisht, gjatë vitit 2026 ka ndjekur, me miratimin dhe financimin e Këshillit të Qarkut Vlorë, një trajnim profesional pranë qendrës ISSAT, në të cilin ka marrë pjesë edhe vetë eprorja e saj direkte, znj. H. . Detyrimi financiar ndaj qendrës, i cili buron nga marrëdhënia kontraktore e institucionit dhe administrohet nga drejtoria e drejtuar nga znj. H. , nuk është shlyer, mospagesë e konfirmuar më 11.06.2026 dhe e pandryshuar deri në datën e paraqitjes së këtij relacioni. Ajo shton se, më datë 06.07.2026, pra pas paraqitjes së ankesës nr. 150, datë 17.06.2026, Qendra ISSAT i ka konfirmuar me shkrim se, i është drejtuar institucionit në mënyrë të përsëritur pa marrë asnjë përgjigje. Rrjedhimisht, sipas ankuseses, si pasojë e mosveprimit të subjekteve,

certifikata e saj profesionale rrezikon anulimin dhe barra financiare e një detyrimi institucional po zhvendoset mbi të. Sipas saj, ky trajtim i disfavorshëm, i vijuar pas datës 17.06.2026, përbën viktimizim në kuptim të nenit 3/17 të LMD-së.

Si pasojë tjetër konkrete me natyrë ekonomike, që sipas saj forcon trajtimin e disfavorshëm, ankuesja parashtron vendimin për zbritjen e një dite pune konkretisht data 25.06.2026, me argumentin se nuk kishte nënshkruar në kohë listëprezencën. Ajo argumenton se ky veprim nuk mund të vlerësohet i shkëputur nga konteksti i përgjithshëm faktik, pasi u ndërmor në vijim të një sërë masash të tjera individuale të drejtuara vetëm ndaj saj, të pasuara nga një mbledhje vetëm për të. Mungesa e nënshkrimit të listëprezencës, sipas saj, nuk provon mungesë reale në punë apo moskryerje të detyrave funksionale, Për rrjedhojë, masa financiare e aplikuar merr karakter selektiv dhe disproporcional.

Në po të njëjtën linjë faktike, ankuesja kërkon të analizohet edhe urdhri individual nr. 109 datë 30.06.2026, lidhur me hartimin e Planit Social në Rang Qarku, i cili iu drejtua vetëm asaj dhe u shoqërua me kërkesa të ndryshueshme e mungesë të bashkëpunimit institucional të nevojshëm për realizimin e tij, edhe pse përmbushja e kësaj detyre kërkonte kontributin e disa strukturave dhe ekspertëve, sipas saj, përgjegjësia u përqendrua ekskluzivisht mbi të, pa u siguruar informacioni dhe mbështetja e domosdoshme, mënyrë veprimi që, krijon ngarkesë pune të diferencuar dhe objektivisht më të rëndë krahasuar me punonjës të tjerë në kushte të krahasueshme.

Ankuesja kërkon që të vlerësohet si viktimizim çdo trajtim i disfavorshëm ndaj saj pas datës 17.06.2026, përfshirë, por pa u kufizuar në, çdo vendim apo masë që buron nga procedimi disiplinor, çdo urdhër të ri që ka dale ndaj saj që e ngarkon me detyra të caktuara, dhe çdo tentativë për ta trajtuar vetë paraqitjen e ankesës si shkelje. Thekson se, sipas praktikës së Komisionerit, ushtrimi i të drejtës për t'u ankuar është i pakufizuar në kohë sa zgjat marrëdhënia e punës dhe nuk mund të cilësohet nga punëdhënësi si “taktikë procedurale” apo abuzim (vendimi nr. 99/2025), as të trajtohet si shpifje apo shkelje etike që të kthehet në shkas masash ndaj ankuesit (vendimi nr. 264/2024).

4. Nëpërmjet e-mailit datë 27.07.2026, pala ankuese ka depozituar parashtrime shtesë në lidhje me ankesën.

Në parashtrimin e datës 27.07.2026, ankuesja sjell në vëmendje të Komisionerit disa rrethana të konstatuara prej saj gjatë ecurisë së procedurës administrative, të cilat, sipas saj, mund të cenojnë materialin provues ose besueshmërinë e procesit.

Së pari, ankuesja pretendon se detyrimi financiar i institucionit ndaj institutit ISSAT, i bazuar në kontratën nr. 228, datë 23.01.2026, dhe në faturën nr. 123, datë 24.04.2026, ka mbetur i pashlyer për rreth dy muaj, pavarësisht se fatura ishte e disponueshme për pagesë që prej prillit 2026, dhe se urdhri i pagesës (UB nr. 101) mban pikërisht datën 17.06.2026, pra të njëjtën datë me regjistrimin e ankesës së saj dhe është ekzekutuar nga thesari më 19.06.2026. Ankuesja pretendon

se refuzimi i mëparshëm për të shlyer këtë detyrim nuk ka pasur natyrë buxhetore, por synonte drejtpërdrejt të pengonte pajisjen e saj me certifikatën e trajnimit, dhe se, edhe pas kryerjes së pagesës, kontrolli mbi certifikatën e saj ka vijuar të mbahet nga institucioni, pasi ishte kërkuar që certifikata t'i dërgohej institucionit dhe jo ankueses. Mbi këtë bazë, ankuesja parashtron dyshimin se përkimi kohor i pagesës me datën e depozitimit të ankesës mund të ketë synuar heqjen e efektit provues të mosshlyerjes.

Së dyti, ankuesja pretendon, mbi bazën e një informacioni që nuk e disponon në formë të dokumentuar, se po në të njëjtën datë 17.06.2026, është mbajtur mbledhja e komisionit disiplinor të ngritur për shqyrtimin e pretendimeve të dy titullarëve ndaj saj, dhe kërkon që kjo rrethanë të verifikohet nga Komisioneri përmes administrimit të procesverbalit të mbledhjes dhe të aktit të ngritjes së komisionit.

Së treti, ankuesja pretendon se, ndryshe nga refuzimi i vazhdueshëm që i ishte bërë që prej muajit prill 2026 për t'u përfshirë në trajnimin dhe certifikimin e ASPA për prokurimet publike, trajnim që kolegë të tjerë, përfshirë eprorën e saj, e kishin ndjekur dhe përfunduar, regjistrimi i saj në provimin përkatës është kryer vetëm në vijim të njoftimit që ajo i kishte bërë Komisionerit me e-mailin e datës 09.07.2026, për këtë fakt viktimizimi, konkretisht diku midis 14 dhe 21.07.2026. Ankuesja e paraqet këtë përkim kohor si tregues se, një kërkesë e mohuar prej muajsh është plotësuar brenda pak ditësh nga parashtrimi i saj pranë institucionit.

Së katërti, ankuesja pretendon se, tetë ditë pas regjistrimit të ankesës nr. 150, datë 17.06.2026, në një mbledhje të datës 25.06.2026, i është ngritur çështja e firmosjes së vonuar të listëprezencës. Në vijim, asaj iu mbajt një ditë pune nga paga, e justifikuar fillimisht me procesverbalin nr. 1797, datë 06.07.2026, dokument që pretendon se nuk iu vu në dispozicion përkundër kërkesës së saj me shkrim të datës 09.07.2026, por vetëm më 21.07.2026, bashkë me një dokument të dytë të asaj kohe, shënimi sqarues nr. 1909, datë 20.07.2026, i cili e riklasifikon mbajtjen si "saktësim teknik" dhe e përshkruan në mënyrë të ndryshme nga dokumenti i parë (mospërputhje mes 5,5 orëve të pallogaritura dhe një dite të tërë të pallogaritur). Ankuesja pretendon se kjo vonesë në dorëzim dhe kjo mospërputhje kërkojnë verifikim nga Komisioneri.

Në lidhje me këto rrethana, ankuesja pretendon se ekziston një element i përbashkët, dhe konkretisht, në secilin rast sipas ankueses, veprimi i institucionit lidhet drejtpërdrejt me elementin që ajo vetë kishte parashtruar pranë Komisionerit, dhe ndodh brenda një afati të shkurtër nga parashtrimi përkatës, që sipas ankueses lë të kuptohet mundësia që informacioni mbi ecurinë e procedurës të mbërrijë te pala kundër së cilës është paraqitur ankesa përpara ose përtej rrugës zyrtare të njoftimit. Ankuesja nuk e paraqet këtë pretendim si të vërtetuar me ndonjë akt ose provë apo të identifikojë ndonjë burim informacioni, por kërkon që ky shqetësim të verifikohet objektivisht nga Komisioneri, në respekt të parimit të paanshmërisë objektive, i cili, sipas saj, kërkon jo vetëm paanshmëri reale, por edhe mungesë dyshimesh të arsyeshme mbi rregullshmërinë e procedurës.

5. Nëpërmjet *e-mailit* datë 04.08.2026, ankueses iu kërkua informacion shtesë nëse subjekt kundër të cilëve është paraqitur ankesa kanë dijeni dhe/ose janë njoftuar nga ana e ankueses për ankesën e paraqitur pranë Komisionerit.

Ankuesja ktheu përgjigje me *e-mailin* e datës 05.08.2026, duke informuar se subjektet ndaj të cilëve është paraqitur ankesa, z. E.M , Kryetar i Këshillit të Qarkut Vlorë, dhe znj. A.H , Drejtore e Drejtorisë së Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Social, nuk janë njoftuar nga ana e saj për paraqitjen e ankesës pranë Komisionerit.

Ankuesja parashtron se, pavarësisht se nuk ka komunikuar me subjektet për ekzistencën e ankesës nr. 150, datë 17.06.2026 të paraqitur pranë Komisionerit, faktet dhe rrethanat që përbëjnë objektin e kësaj ankese u janë parashtruar atyre përpara fillimit të procedimit administrative pranë Komisionerit, nëpërmjet komunikimeve dhe shkresave zyrtare, të cilat janë depozituar pranë institucionit. Dokumentacioni i sipërcituar, i cili është vënë në dispozicion të Komisionerit, provon se faktet dhe pretendimet që përbëjnë objektin e ankesës kanë qenë objekt i komunikimeve zyrtare të ankueses me institucionin përpara depozitimit të saj pranë Komisionerit. Gjithashtu ankuesja vë në dukje se gjatë gjithë periudhës së shqyrtimit administrativ të ankesës vazhdon të ushtroj detyrën pranë të njëjtit institucion dhe në të njëjtat kushte pune që kanë shërbyer si bazë e pretendimeve të saj. Ankuesja parashtron se, trajtimi i pretenduar diskriminues nuk ka pushuar, por ka vijuar edhe pas paraqitjes së ankesës. Vazhdueshmëria e kësaj situate po prodhon pasoja të konsiderueshme profesionale dhe psikologjike, duke ndikuar drejtpërdrejt në ushtrimin normal të detyrës, në cilësinë e jetës dhe mirëqënien e saj.

III. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta në nenin 18, si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllëjta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Ky parim presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta dhe vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive mund të përliqet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë (*Vendimet nr. 31 datë 04.10.2021, nr. 27, datë 29.06.2021; nr. 20, datë 20.04.2021; nr. 10, datë 29.02.2016; nr. 48, datë 15.11.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, duke sanksionuar parimin e barazisë para ligjit, nuk i ka dhënë atij kuptimin e një të drejte absolute, sepse ajo ka përcaktuar njëkohësisht edhe kushtet e kufizimit në ushtrimin e kësaj të drejte. Paragrafi i tretë i nenit 18 të Kushtetutës pranon kufizimet e të drejtës për barazi me përmbushjen e disa kushteve të posaçme, pikërisht të përliqjes së

arsyeshme dhe objektive. (Vendimi nr. 19, datë 09.07.2009 i Gjykatës Kushtetuese). Ky parim kërkon që të gjitha subjektet të trajtohen në mënyrë të njëjtë, por nuk formulon ndalime që të mund të bëhen trajtime të diferencuara kur individët e grupet nuk ndodhen në kushte të njëjta a të ngjashme, apo kur ka justifikim të arsyeshëm e objektiv, duke vendosur një raport të arsyeshëm dhe përpjesëtimor midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet. (Vendimet nr. 18, datë 29.07.2008 dhe nr.19, datë 09.07.2019 të Gjykatës Kushtetuese).

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, ndërkohë që Protokolli 12-të i KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe sesa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet⁴.

Sipas GJEDNJ-së, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu cenohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve është objektivisht e ndryshme⁵. Referuar jurisprudencës së GJEDNJ-së, diskriminimi i drejtpërdrejtë, edhe pse neni 14 i KEDNJ-së nuk jep një përkufizim të tij, konsiderohet si “dallim në trajtim i personave në situata të njëjta ose të ngjashme” dhe “bazuar në një karakteristikë ose “status” të dallueshëm”⁶.

Ligji Nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me një listë të hapur shkaqesh, duke sanksionuar në nenin 1, të tij se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Bazuar në nenin 3, pika 1, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar (LMD), diskriminimi përcaktohet si : “çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në

⁴ Shih: Molla kundër Greqisë, Vendim i Dhomës së Madhe, 2018, prg. 135; Fábíán kundër Hungarisë, Vendim i Dhomës së Madhe 2017, prg. 113; Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar, 1985, prg.72.

⁵ Shih: Çështja Thlimmenos kundër Greqisë [GC], nr. 34369/97, prg. 44, GJEDNJ 2000-IV; Çështja J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24.10. 2019.

⁶ Shih: Biao kundër Danimarkës, Dhoma e Madhe, datë 14.05.2016, § 89, Carson dhe të Tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar, Dhoma e Madhe 2010, datë 16.03.2010, prg. 61.

cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.”

Në thelb të diskriminimit, është trajtimi i diferencuar dhe më pak i favorshëm, i shfaqur qoftë në formën e dallimit, kufizimit, përjashtimit ose preferencës dhe që ka për bazë një nga shkaqet e mbrojtura nga ligji. Pra, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit. Gjithashtu, jo çdo diferencë në trajtim është diskriminim, por vetëm ato që nuk kanë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Pra, nëse për diferencën në trajtim konstatohet se ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, atëherë trajtimi ndryshe është i përligjur dhe nuk është i ndaluar nga ligji. Për të pasur një pretendim për diskriminim, duhet domosdoshmërisht që të identifikohet një shkak, i cili në bazë të ligjit është i ndaluar ose i mbrojtur. Shkakut i diskriminimit përmbën një nga elementët thelbësor për të paraqitur një pretendim për diskriminim.

Si rregull, në lidhje me shkakun e pretenduar të diskriminimit, pala ankuese duhet të provojë *në radhë të parë* se, shkakut i pretenduar është një shkak që gëzon mbrojtje sipas ligjit, dhe në radhë të dytë duhet të provojë ekzistencën e tij. E njëjta qasje gjen zbatim edhe kur pretendohet se diskriminimi ka ndodhur për më shumë se një shkak. Megjithatë, vetëm identifikimi i një ose më shumë shkaqeve, të cilat mbrohen në mënyrë të shprehur nga ligji, nuk është e mjaftueshme për të ngritur një pretendim për diskriminim. Personi i cili pretendon se është diskriminuar për një ose më shumë se një, nga shkaqet e mbrojtura, duhet të parashtrojë fakte nga të cilat mund të prezumohet se ka një diferencë në trajtim dhe se kjo diferencë në trajtim pretendohet se ka si bazë shkakun ose shkaqet e mbrojtur/a.

Vlerësimi i Komisionerit

- Në lidhje me shkakun e pretenduar të diskriminimit “*cilësisë si punonjëse që kundërshtoi zbatimin e një urdhri të paligjshëm dhe që raportoi paligjshmërinë e konstatuar tek eprorët dhe tek organet kompetente*”, në kuadër të “*çdo shkak tjetër*”.

Për të pasur një pretendim për diskriminim, pala ankuese duhet të provojë, *në radhë të parë*, se shkakut i pretenduar është një shkak që gëzon mbrojtje sipas ligjit, dhe, *në radhë të dytë*, duhet të provojë ekzistencën konkrete të tij, pra që pala e mbart këtë shkak.

Shkakut i pretenduar i diskriminimit nuk duhet vetëm të konsiderohet si shkak i mbrojtur sipas ligjit, por duhet të provohet se ankuesja e mbart këtë shkak dhe se detyrimi për të provuar shkakun

e pretenduar të diskriminimit i takon palës ankuese. Kjo qasje ndaj barrës së provës është e domosdoshme, pasi Komisioneri nuk mund të hetojë mbi baza abstrakte apo thjesht supozimet e palës ankuese. Duhet të ekzistojë një minimum informacioni faktik dhe provues që lidh trajtimin e pretenduar të pafavorshëm me një shkak të mbrojtur konkret.

Nga shqyrtimi i ankesës dhe i parashtrimeve plotësuese të paraqitura nga pala ankuese, Komisioneri konstaton se shkak i pretenduar i diskriminimit, sipas ankueses, konsiston në *“cilësinë e saj si punonjëse që kundërshtoi zbatimin e një urdhri të paligjshëm dhe që raportoi paligjshmërinë e konstatuar tek eprorët dhe tek organet kompetente”*, duke e lidhur këtë pretendim konkretisht me refuzimin e saj, të pretenduar në datën 13.03.2026, për të protokolluar një kontratë me nënshkrime elektronike me data që nuk përputheshin, si dhe me raportimin e mëvonshëm të kësaj çështjeje tek organet kompetente. Komisioneri konstaton se, shkak i pretenduar nga pala ankuese si shkak diskriminimi, nuk parashikohet shprehimisht nga neni 1 i LMD.

Neni 1, i LMD, liston disa shkaqe, megjithatë kjo listë nuk është e mbyllur por ilustruese, fakt ky që rezulton nga përfshirja në këtë listë e shprehjes për *“çdo shkak tjetër”*. Thënë kjo, nuk presupozon se, termi *“çdo shkak tjetër”* përbën një shkak në vetvete. Rregullimi i bërë nga neni 1, i LMD-së nëpërmjet termit *“çdo shkak tjetër”* mundëson mbrojtjen nga diskriminimi për shkaqe të tjera, përveç shkaqeve të listuara shprehimisht në këtë dispozitë të ligjit, por duke identifikuar *“shkakun”* i cili pretendohet se gëzon mbrojtje në kuadër të termit *“çdo shkak tjetër”*.

LMD, por edhe legjislacioni ndërkombëtar në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi, nuk ka parashikime ose përkufizim se çfarë është shkak i mbrojtur. Sipas praktikës së GJEDNJ-së, neni 14, i KEDNJ-së nuk ndalon të gjitha dallimet në trajtim, por vetëm ato diferenca të bazuara në një *karakteristikë personale të identifikueshme, objektive ose personale, ose “status”, me të cilin personat ose grupet e personave janë të dallueshëm nga njëri-tjetri*.

Komisioneri vlerëson se, edhe sikur të pranohej, në parim, se cilësia e një punonjësi që raporton parregullsi ose paligjshmëri të konstatuara në punë mund të përbëjë shkak të mbrojtur në kuptim të *“çdo shkak tjetër”* sipas nenit 1 të LMD-së, kjo karakteristikë duhet të provohet, duhet të ekzistojë realisht dhe në mënyrë të verifikueshme te ankuesja konkrete, dhe jo të mbetet një pohim i vetëdeklaruar, i pambështetur nga asnjë element objektiv. Në rastin konkret, nga aktet dhe parashtrimet e administruara, Komisioneri konstaton sa më poshtë:

Së pari, vetë akti i pretenduar si gjenerues i të gjithë zinxhirit të ngjarjeve, refuzimi i ankueses për të protokolluar kontratën, më datë 13.03.2026, nuk provohet me asnjë dokument por bazohet vetëm në pohimin e ankueses. Nga dokumentacioni i depozituar nuk rezulton asnjë shkresë e protokolluar, e nënshkruar nga ankuesja, me të cilën ajo të ketë kundërshtuar zyrtarisht protokollimin e kësaj kontrate në datën e pretenduar, as ndonjë akt tjetër i institucionit që të konfirmojë objektivisht se ky refuzim ka ndodhur në datën e pretenduar nga ankuesja.

I vetmi fakt i provuar me dokumentacion është marrja e masës disiplinore *“Vërejtje”*, me shkresën nr. 698 Prot., datë 13.03.2026, të eprorit direkt. Megjithatë, ky akt provon vetëm ekzistencën e

masës disiplinore dhe datën e marrjes së saj, por jo shkakun konkret që ka çuar në vendosjen e saj. Për rrjedhojë, për sa kohë që nuk provohet objektivisht se masa disiplinore është marrë si pasojë e refuzimit të pretenduar për të protokolluar kontratën, nuk mund të konkludohet se ajo është marrë për këtë arsye, ndaj nuk ekziston një bazë faktike e mjaftueshme për të lidhur masën disiplinore me një shkak të mbrojtur.

Së dyti, kronologjia e vetë veprimeve të ndërmarra nga ankuesja në funksion të denoncimit të pretenduar konfirmon këtë mangësi provuese në lidhje me shkakun e pretenduar të diskriminimit. Konkretisht, kallëzimi penal ndaj z. E.M dhe znj. A.H , është depozituar pranë organeve të policisë më datë 21.05.2026, pra më shumë se dy muaj pas datës së pretenduar të kundërshtimit, datë 13.03.2026 dhe pas gjithë zinxhirit të ngjarjeve që ankuesja e paraqet si pasojë të drejtpërdrejtë të këtij refuzimi. Kallëzimi është përcjellë nga Policia në Prokurori më datë 22.05.2026 dhe në vijim Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë ka regjistruar kallëzimin penal nr.795, datë 25.05.2026 të paraqitur nga ankuesja. Pas shqyrtimit të kallëzimit, me vendimin “Për mosfillimin e procedimit penal” të datës 08.06.2026, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë ka vendosur mosfillimin e procedimit penal më datë 08.06.2026.

Në këto kushte, rezulton se ekziston një interval prej më shumë se dy muajsh ndërmjet datës së pretenduar të kundërshtimit, 13.03.2026, dhe depozitimit të kallëzimit penal më datë 21.05.2026 pranë Seksionit për Hetimin e Krimit Ekonomik dhe Financiar në Drejtorinë Vendore të Policisë Vlorë. Ky interval kohor nuk mbështet pretendimin e ankueses se kallëzimi penal përbën një reagim të menjëhershëm dhe të drejtpërdrejtë ndaj ngjarjes së pretenduar, duke dobësuar lidhjen faktike ndërmjet këtyre dy ngjarjeve.

Së treti, i njëjti arsyetim vlen edhe për ankesën e paraqitur nga ankuesja pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e cila mban datën 26.05.2026. Ankesa pranë këtij institucioni është paraqitur pas shumicës së akteve që ajo i konsideron si pjesë të trajtimit të disfavorshëm.

Së katërti, në lidhje me statusin e “sinjalizueses“ sipas Ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, i ndryshuar, në radhë të parë, Komisioneri vëren se njohja e këtij statusi i nënshtrohet kushteve dhe procedurës së parashikuar shprehimisht nga ai ligj, dhe se kompetenca për njohjen e tij i takon Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI). Nga aktet e administruara rezulton se kërkesa e ankueses për njohjen e statusit të sinjalizueses dhe për mbrojtje nga hakmarrja, sipas Ligjit nr. 60/2016, është depozituar pranë ILDKPKI-së nëpërmjet *e-mailit* që mban datën 18.06.2026, pra një ditë pas depozitimit të vetë ankesës te Komisioneri (nr. 150, datë 17.06.2026) dhe në çdo rast, mbi tre muaj pas datës së pretenduar si gjeneruese e zinxhirit të sjelljeve të pretenduara si diskriminuese në ankesën objekt shqyrtimi (data 13.03.2026) dhe pas përfundimit të pjesës më të madhe të ngjarjeve që ankuesja i cilëson si pasojë e kësaj cilësie.

Kjo do të thotë se, në të gjithë periudhën kur, sipas ankueses, ka ndodhur trajtimi i pretenduar si i disfavorshëm, ajo nuk zotëronte, madje as nuk kishte kërkuar formalisht, njohjen e statusit ligjor

mbi të cilin e mbështet shkakun e pretenduar të diskriminimit. Konstatimi i shkakut nuk mund të bazohet vetëm në renditjen kronologjike të ngjarjeve pa u shoqëruar me elementë faktikë të verifikueshëm mbi bazën e provave.

Komisioneri vëren se ankuesja ndërton një lidhje shkakësore ndërmjet shkakut të pretenduar të diskriminimit dhe masave të ndërmarra ndaj saj të pretenduara si trajtim i padrejtë, duke u mbështetur kryesisht në renditjen kronologjike të ngjarjeve. Megjithatë, lidhja kohore ndërmjet kundërshtimit dhe fillimit të masave nuk është e mjaftueshme, në vetvete, për të provuar ekzistencën e shkakut të mbrojtur të diskriminimit sipas LMD.

Nga dokumentacioni i depozituar bashkëlidhur ankesës, si dhe nga parashtrimet plotësuese të paraqitura pas kërkesës së Komisionerit, nuk rezulton asnjë provë apo indicie e cila provon pretendimin e ankuses në lidhje me shkakun e diskriminimit.

Në kuadër të shqyrtimit paraprak, Komisioneri, me qëllim plotësimin e mungesave të evidentuara, i dha mundësinë palës ankuese të paraqesë prova shtesë lidhur me shkakun e mbrojtur të diskriminimit. Pas shqyrtimit të parashtrimeve plotësuese, Komisioneri konstaton se pala ankuese nuk ka paraqitur shpjegime apo prova që të identifikojnë dhe të provojnë ekzistencën e shkakut të mbrojtur të diskriminimit.

Shkaku i diskriminimit, nuk mund të supozohet apo nënkuptohet. Ai duhet të identifikohet dhe provohet, qoftë edhe përmes provave indirekte apo indiciesh të besueshme. Në rastin konkret, Komisioneri nuk disponon asnjë informacion faktik apo provues, qoftë edhe në formën e indicieve që të lejojë identifikimin e shkakut të mbrojtur të diskriminimit dhe hetimin e mëtejshëm nëse trajtimi i pretenduar si i pafavorshëm është pasojë e atij shkakut.

Mungesa e informacionit të mjaftueshëm në lidhje me shkakun e mbrojtur të diskriminimit e bën të pamundur fillimin e hetimit dhe vazhdimin e shqyrtimit të ankesës në fazat e mëtejshme procedurale. Nëse Komisioneri do të vijonte hetimin pa u provuar shkakun e mbrojtur, kjo do të sillte transformimin e rolit të tij institucional nga organ hetimi i diskriminimit në organ që shqyrton ligjshmërinë, funksion ky i cili i takon organeve të tjera dhe gjykatës⁷.

Komisioneri vlerëson se, bazuar në faktet dhe provat e administruara, nuk provohet, as edhe në nivel *prima facie*, ekzistenca e shkakut të pretenduar të diskriminimit në kuadër të “çdo shkak tjetër”/“*cilësia si punonjëse që kundërshtoi zbatimin e një urdhri të paligjshëm dhe që raportoi paligjshmërinë e konstatuar tek eprorët dhe tek organet kompetente*”.

- Në lidhje me shkakun e pretenduar të diskriminimit “*gjendja familjare*”

Ankuesja pretendon se gjendja e saj familjare, e identifikuar prej saj si detyrimi ligjor dhe njerëzor për t'u kujdesur për babain e sëmurë rëndë me tumor, i cili i është nënshtruar ndërhyrjeve kirurgjikale dhe kimioterapive gjatë periudhës 15.03–02.04.2026, përbën shkak të mbrojtur nga

⁷ Për referencë shih vendimin nr. 149, datë 02.06.2026, të Komisionerit.

neni 1 i LMD-së, dhe se institucioni e ka shfrytëzuar këtë gjendje si mjet presioni ndaj saj. Komisioneri vlerëson se ky pretendim nuk është i bazuar, për arsye vijuese.

Së pari, koncepti i “gjendjes familjare”, si shkak i mbrojtur nga neni 1 i LMD-së, i referohet një statusi civil dhe të qëndrueshëm të personit brenda njësisë familjare, statusi i të cilit e dallon atë nga persona të tjerë dhe jo çdo rrethane apo ngjarjeje që lidhet me jetën familjare të një individi. Kujdesi ndaj një prindi të sëmure, padyshim që përbën një detyrim njerëzor dhe moral. Por jo çdo vështirësi apo ngjarje brenda familjes konsiderohet automatikisht “gjendje familjare” në kuptim të shkakut të mbrojtur të LMD-së.

Së dyti, Komisioneri vëren se ankuesja nuk pretendon dhe nuk provon të ketë ndonjë status të posaçëm ligjor kujdestarie ndaj babait të saj, sipas dispozitave përkatëse të Kodit të Familjes. Nga aktet nuk rezulton që babai i ankueses të jetë deklaruar person me aftësi të kufizuar për të vepruar dhe që ankuesja të jetë caktuar kujdestare e tij me akt të organit kompetent. Detyrimi i saj për ta shoqëruar në ekzaminime dhe ndërhyrje mjekësore, edhe sikur të jetë real, buron nga marrëdhëniet e zakonshme prind-fëmijë dhe nga solidariteti familjar, dhe jo nga një status i posaçëm ligjor përgjegjësie kujdestarie që do ta bënte atë subjekt të një kategorie të identifikueshme e të mbrojtur më vete nga neni 1 i LMD-së.

Së treti, nga aktet e administruara nuk rezulton që ankuesja të ketë njoftuar paraprakisht punëdhënësin për nevojat apo kufizimet e saj në këtë drejtim, përpara se t'i ngarkoheshin detyrat që ajo i konsideron si objektivisht të përealizueshme. Nga vetë parashtrimet e ankueses rezulton se ajo e ngre këtë pretendim vetëm në momentin kur i ngarkohen këto detyra, në kuadër të kundërshtimit të tyre, dhe jo paraprakisht, si informacion i vënë në dijeni të punëdhënësit për t'u marrë parasysh në planifikimin e ngarkesës së saj të punës. Në mungesë të një dijenie paraprake për këtë rrethanë, nuk mund të provohet as lidhja shkakësore e kërkuar nga ligji ndërmjet shkakut të pretenduar të diskriminimit dhe trajtimit të pretenduar si të disfavorshëm (afatet dhe ngarkesat e vendosura), pasi një punëdhënës nuk mund të konsiderohet se ka vepruar duke marrë parasysh, një rrethanë për të cilën nuk ka patur dijeni. Nga aktet e administruara konstatohet se, vetëm me shkresën nr.1254 prot., datë 14.05.2026 me lënëdhë “Përgjigje Urdhërit Nr.83, datë 13.05.2026 “Pjesëmarrjen e stafit në bashkëorganizimin e aktivitetit “Sofra Konispolate”, ankuesja ka parashtruar si argumenta për pamundësinë e zbatimit të këtij urdhri, i cili rezulton se nuk i drejtohet vetëm ankueses, pretendimin se duhet të shoqërojë babain e saj për kryerjen e konsultave mjekësore.

Komisioneri thekson, në këtë kuadër, se jo çdo problematikë apo vështirësi që mund të hasë një punonjës në jetën e tij familjare përkthehet automatikisht në një detyrim ligjor për punëdhënësin sipas legjislacionit për mbrojtjen nga diskriminimi.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se pretendimi i ankueses për diskriminim për shkak të “gjendjes familjare” nuk është i bazuar.

- Në lidhje me pretendimin për viktimizim.

Sa i takon pretendimit të ankueses për viktimizim, Komisioneri i referohet nenit 3, pika 17, të LMD, sipas të cilit: “ 17. “Viktimizimi” është trajtim i disfavorshëm ose pasojë negative, që vjen si reagim ndaj një ankimi a një procedimi, që synon zbatimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, sipas parashikimeve të nenit 1 të këtij ligji, lidhur me pretendimin për diskriminim të ankuesit.”

Rezulton se, deri në momentin e paraqitjes pranë Komisionerit të ankesës nr.150, datë 17.06.2026, ankuesja nuk ka paraqitur ndonjë ankesë për diskriminim pranë punëdhënësit.

Referuar parashtrimeve të palës ankuese, ajo e lidh pretendimin për viktimizim me paraqitjen e ankesës pranë Komisionerit. Në informacionin plotësues të datës 17.07.2026 dhe në parashtrimin e datës 27.07.2026, ankuesja ka parashtruar ngjarje dhe akte të ndodhura në datën 17.06.2026 si dhe pas kësaj date, konkretisht, ekzekutimi i pagesës ndaj institutit ISSAT (19.06.2026), mbledhja e pretenduar e komisionit disiplinor në datë 17.06.2026; mbajtja e listëprezencës dhe zbritja e një dite pune nga paga në datë 25.06.2026, urdhri Nr. 109, datë 30.06.2026, procesverbalet nr. 1797, datë 06.07.2026 dhe shënimi sqarues nr. 1909, datë 20.07.2026, si dhe regjistrimi në provimin e ASPA-s në muajin korrik 2026, duke pretenduar se këto veprime nga ana e punëdhënësit përbëjnë trajtim të padrejtë dhe të disfavorshëm ndaj saj, trajtim që vjen si pasojë e paraqitjes së ankesës pranë Komisionerit.

Nga aktet e administruara dhe parashtrimet e palës ankuese, nuk rezulton e provuar se subjektet kundër të cilëve është paraqitur ankesa, të kenë dijeni lidhur me ankesën që ankuesja ka paraqitur pranë Komisionerit, dhe që pretendohet se ka shërbyer si shkak për pasojat negative të pretenduara nga ankuesja se i kanë ardhur pas datës 17.06.2026.

Komisioneri vlerëson se, në kushtet kur, nuk provohet dijenia e subjekteve kundër të cilëve është paraqitur ankesa, nuk mund të pretendohet ose të prezumohet, qoftë edhe në nivel *prima facie*, se trajtimi i padrejtë i pretenduar se ka ardhur pas datës 17.06.2026, mund të jetë pasojë e ankesës për diskriminim të paraqitur nga ankuesja pranë Komisionerit.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se pretendimi i ankueses për viktimizim, është haptazi i pabazuar.

- Në lidhje me pretendimet e ngritura në parashtrimin e datës 27.07.2026 për paanshmërinë e procedurës.

Në parashtrimin e datës 27.07.2026, ankuesja ka ngritur pretendimin se informacioni mbi ecurinë e shqyrtimit të ankesës së saj mund t'i ketë mbërritur subjekteve ndaj të cilëve është drejtuar ankesa, përpara ose përtej rrugës zyrtare të njoftimit, duke kërkuar verifikim.

Komisioneri sqaron se, siç rezulton edhe nga vetë kronologjia e procedurës së paraqitur në pjesën II të këtij vendimi, gjatë fazës së shqyrtimit paraprak të ankesës nr. 150, datë 17.06.2026, të gjitha komunikimet janë kryer ekskluzivisht me palën ankuese, konkretisht: kërkesa për plotësim e datës 29.06.2026, kërkesa për ridërgim dokumentacioni e datës 16.07.2026, kërkesa për informacion shtesë e datës 04.08.2026, si dhe marrja në shqyrtim e parashtrimeve/informacioneve të ankueses të datave 09.07.2026, 17.07.2026, 27.07.2026 dhe 05.08.2026. Nga verifikimi i të dhënave të administruara nga Komisioneri rezulton se, gjatë kësaj faze paraprake, subjektet ndaj të cilave është drejtuar ankesa, z. E.M dhe znj. A.H , nuk janë kontaktuar zyrtarisht në asnjë formë, as me shkresë, as me e-mail, as nëpërmjet ndonjë mënyre tjetër komunikimi, dhe as nuk u është përcjellë ndonjë informacion apo dokumentacion në lidhje me ankesën. Kjo pasi shqyrtimi paraprak, në këtë fazë procedurale, ka për qëllim vetëm verifikimin formal të ankesës dhe të kushteve ligjore për pranimin e saj, dhe jo shqyrtimin kontradiktor me palën tjetër, i cili do të vijonte vetëm nëse ankesa do të kalonte fazën e vlerësimit paraprak të pranueshmërisë.

Për sa më sipër, pretendimi i ankueses se informacioni mbi ecurinë e procedurës mund t'u jetë komunikuar subjekteve përpara ose përtej rrugës zyrtare të njoftimit nuk gjen mbështetje në të dhënat objektive të administruara nga Komisioneri, të cilat tregojnë qartësisht se, gjatë kësaj faze, i vetmi komunikim i institucionit ka qenë vetëm ankuesja.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës dhe bazuar në nenin 33, pika 4, gërma “ç” të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ku parashikohet se: *“4. Ankesa nuk pranohet nëse: ç) është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim;”*, Komisioneri vlerëson se ankesa objekt shqyrtimi nuk duhet të pranohet, pasi është haptazi e pabazuar dhe nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim. Në kushtet kur ankesa nuk përmbush kriteret ligjore, ajo nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Konstatimi se ankesa është haptazi e pabazuar sipas LMD-së nënkupton vetëm se pretendimet e parashtruara nuk plotësojnë kriteret ligjore të nevojshme për ngritjen e një pretendimi për diskriminim. Ky konstatim nuk përbën dhe nuk duhet interpretuar si vlerësim i Komisionerit mbi bazueshmërinë e pretendimeve të ankueses jashtë fushës së LMD-së, as si mohim i faktit se ankuesja mund të ketë të drejta të cenuara, për të cilat ajo mund t'i drejtohet autoriteteve kompetente, përfshi gjykatën.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32/1/a , nenin 33, pika 4, gërma “ç” të ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës nr.150 Regj., datë 17.06.2026, të paraqitur nga znj. I.L , pasi nuk përmbushen kushtet ligjore për pranimin e ankesës, të përcaktuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Genta TAFA (BUNGO)

Shkaku: “*gjendja familjare*”, “*çdo shkak tjetër*”
Fusha: Punësim
Lloji i vendimit: Mospranim